



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 1 / 076

Datë 24/11/2020

KONTRATË

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson Drejtori i Prokurimit Muhadin Halili në njërën anë:

dhe

Muharrem S Rushiti B.I.,N..SH,, Kastrioti,, **PRELEZ I JERLIVE**, Ferizaj që përfaqëson Muharrem Rushiti ,nr. i tel.044-130-493 ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për punët e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i serës tek shkolla profesionale në Shtime

Prokurimi: 617-20-6888-5-3-6

Nr i brendshëm: 617-2020-082-536

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Ndërtimi i serës tek shkolla profesionale në Shtime**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **25.11.2020 dhe përfundon me 18.12.2020**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **15 ditë** nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i punimeve do të jetë : **Shkolla Profesionale Shtime**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 5,037.20 €
(Pesëmijë e tridhjetë e shtatë euro e njëzetë centi)**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa OE do të bëhet pasë përfundimit të punimeve dhe pranimit teknik të Serres , të dëshmuara me raport nga menegjeri i projektit dhe raporti pranimit teknik nga komisioni.

Për pagesë OE duhet të sjell këto dokumente :

1. Fatura e rregullt
2. Raporti i menaxherit të projektit
3. Raporti i pranimit teknik nga komisioni

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *punëve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni *N/A*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk *arrin te kryej ndonjë ose te gjitha punët* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *punëve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Muharrem Rushiti	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.11.2020	Data:	24.11.2020
Vula:		Vula:	

Objekt parashkollor-Çerdhe P+0, Llabjan - Novoberde
PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER NDERTIMIN E SERES TEK SHKOLLA PROFESIONALE						
SERRE E TIPIT "TUNEL" me dimensione L/B/H=50.0/8.0/4.2 m						
Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancianin si dhe kompletimin e certifikatave dhe afesteva të prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaritja e pozicioneve të bëhet sipas gjendjes së realizuar në terren.						
Nr	Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
I PUNËT PARAPERGADITORE						
1.1	Bartjen e te dhenave ne terren, sinjalizimi dhe rrethimi I vendpunishtes duke perfshire montimin e tabelës informuese, instalimi I perkohshem I rrjetit elektrik, ujesjellesit&kanalizimit dhe ndricimit te kantierit.	cope	1.00	€ 100.00	€	100.00
TOTAL PUNËT PARAPERGADITORE					€	100.00
II PUNËT E THEMELEVE						
2.1	Germimi dheut me makineri adekuate dhe dore per hapjen e themeleve te vecuara me dimensione 50x50x60 cm dhe transporti i dheut ne deponin e qytetit. Germimi te behet sipas kuotave te dhena ne projekt. Sipërfaqet anesore te gemimit te jene te rregullta, ndersa fundi te jete e niveluar.	m ³	16.00	€ 60.00	€	960.00
2.1	Furnizimi me material dhe betonimi I themeleve te vecuara me dimensione 50x50x60 cm dhe vendosja e ankerave baze (gyp metalik I zinktuar Ø42 mm me thellesi 500 mm) dhe ankerave perforcues (gyp metalik I zinktuar Ø21 mm me thellesi 500 mm). Ne cmim te kalkulohen edhe bazat stop metalike me dimensione 220x200x2 mm, si dhe armatura e nevojshme. Llogaria per cope te themelit.	cope	56.00	€ 8.00	€	448.00
TOTAL PUNËT E THEMELEVE					€	1408.00
III PUNËT E KONSTRUKSIONIT						
3.1	Furnizimi me material dhe montimi I shtyllave dhe harqeve me gypa metalik te zinktuar me dimensione Ø48 mm dhe trashesi 2 mm te cilet duhet te vendosen ne distance prej 2.0 m nga njera tjetra ne anen gjatesore te serres.	m'	370.00	€ 2.20	€	814.00
3.2	Furnizimi me material dhe montimi I gypave horizontal lidhes metalik te zinktuar me dimensione Ø32 mm dhe trashesi 2 mm. gypat vendosen ne dy pjeset anesore ne tere gjatesine e seres. Njeri gyp vendoset ne lartesi 60 cm nga toka, ndersa tjetri ne lartesi 220 cm nga toka, dhe nje ne pjesen e eperme te shtylles.	m'	300.00	€ 1.70	€	510.00
3.3	Furnizimi me material dhe montimi I gypave horizontal lidhes metalik te zinktuar me dimensione Ø25 mm dhe trashesi 1.5 mm. gypat vendosen mbi harqet ne tere gjatesine e seres. Vendosja behet nje ne mes(maje) dhe dy anesore, si dhe gypat mbi dyert ne ballinat e seres .	m'	150.00	€ 1.00	€	150.00



Objekt parashkollor-Çerdhe P+0, Llabjan - Novoberde
PARAMASA DHE PARALLOGARIA

3.4	Furnizimi me material dhe montimi I dy gypave horizontal metalik te zinktuar me dimensione Ø32 mm dhe trashesi 2 mm. Gypat vendosen ne anen e mbrendshme te seres dhe shërbejne per fiksimin e telave per lidhjen e bimeve.	m'	100.00	€	1.00	€	100.00
3.5	Furnizimi me material dhe montimi I gypave metalik te zinktuar me dimensione Ø25 mm dhe trashesi 1.5 mm. Gypat shërbejne per mbushjen e kapriatave te harqeve, dhe vendosen nga nje gyp vertikal dhe dy diagonale per cdo hark.	m'	100.00	€	1.70	€	170.00
3.6	Furnizimi me material dhe montimi I gypave metalik te zinktuar me dimensione Ø32 mm dhe trashesi 2 mm. Gypat shërbejne per shtangimin e pjeses se eperme te shtyllave dhe brezit te eperme te harqeve, dhe jane me gjatesi L= 1.0 - 1.5 m	m'	80.00	€	1.70	€	136.00
3.7	Furnizimi me material dhe montimi I gypave metalik te zinktuar me dimensione Ø32 mm dhe trashesi 2 mm. Gypat shërbejne si shtangim ne forme X ne fushen e pare, fushen e mesit dhe te fundit ne drejtinin gjatesor te seres ne te dy anet. Gjithsejt jane 6 shtangime ne forme X ne te dy anet gjatesore, me gjatesi te gypave L~3.0 m.	m'	40.00	€	1.70	€	68.00




Objekt parashkollor-Çerdhe P+0, Llabjan - Novoberde
PARAMASA DHE PARALLOGARIA

3.8	Furnizimi me material dhe montimi I lidheseve speciale per lidhjen e gypave pa shpuarje ne cdo nyje lidhese te konstruksionit. Dimensionet e lidheseve duhet te jene adekuate sipas dimensioneve te gypave, te jene nga I njeiti prodhues dhe te montohen ne baze te specifikimeve te dhena nga prodhuesi. Llogaria ne cope per komplet konstruksionin.	cope	1.00	€ 250.00	€ 250.00
3.9	Furnizimi me material dhe montimi elementeve te nevojshme per sistemin e ventilimit anesor ne te dy anet gjatesore te serres. Ventilimi duhet te behet nga lartesia 60 cm nga toka deri ne lartesi 220 cm nga toka (hapje me lartesi 160 cm). Ne cmim te kalkulohet edhe mekanizmi per hapje dhe mbyllje te folies. Llogaria ne m'	m'	100.00	€ 2.00	€ 200.00
3.10	Furnizimi me material dhe montimi dyerve rreshqitese ne dy anet ballore te serres. Dyeret duhet te jene me lartesi H=220 cm dhe gjeresi L=230 cm. Dyeret duhet te punohen me konstruksion nga gypat e metali te zinkuar Ø25 mm dhe trashesi 1.5 mm, dhe mbushja me folie te njete me mbulesen e serres. Ne cmim te kalkulohen edhe lidheset e gypave dhe te gjitha aksesoret e nevojshem per hapjen dhe mbylljen e dyerve.	cope	2.00	€ 50.00	€ 100.00
3.11	Furnizimi me material dhe montimi folies antidrip, trashësia 160µ, UHV, me te gjithë parametrat per kushte klimatike ne Kosove qëndrueshmëri së paku 3 vite dhe përforcohet për gypa të metaltë në serrë me klipa special plastik. Folia duhet te vendoset ne tere kulmin e serres, pjeset anesore dhe ballore. Ne cmim te kalkulohen edhe perforcuesi i folies nga materiali i plastikes dhe te gjitha elementet e nevojshme per lidhjen e filies me konstruksionin e serres. Llogaria ne m2 te siperfaqes se rrafshite te serres (dimensionet e serres L/B=50.0/8.0 m	m²	400.00	€ 2.00	€ 800.00
TOTALI PUNET E KONSTRUKSIONIT					€ 3,298.00
IV. PUNET E SISTEMIT TE UJITJES					
4.1	Furnizimi dhe montimi I rezervuarit te plastikes me vellim 1000 L I cili sherben per sistemin e ujitjes. Ne cmim te kalkulohet edhe punimi I bazamentit dhe konstruksionit te nevojshem per ngritje te rezervuarit, si dhe te gjitha pjeset fazonike per lidhjen e rezervuarit me rrjetin egzistues.	cope	1.00	€ 145.00	€ 145.00
4.2	Furnizimi me material dhe montimi I filterit 5/4 me komplet lidheset dhe pjeset fazonike te nevojshme per lidhje.	cope	1.00	€ 12.00	€ 12.00
4.3	Furnizimi me material dhe montimi I gypit kryesor 5/4 per ujitje. Ne cmim te kalkulohen edhe te gjitha pjeset fazonike per lidhjen e gypave.	m'	12.00	€ 0.60	€ 7.20
4.4	Furnizimi me material dhe montimi I mbyllesit 5/4 ne fund te gypit kryesor. Ne cmim te kalkulohen edhe te gjitha pjeset fazonike per lidhje.	cope	1.00	€ 1.00	€ 1.00



Objekt parashkollor-Çerdhe P+0, Llabjan - Novoberde
PARAMASA DHE PARALLOGARIA

4.5	Furnizimi me material dhe montimi i ventilave Ø16 mm. Ne cmim te kalkulohen edhe te gjitha pjeset fazonike per lidhje.	cope	12.00	€	0.50	€	6.00	
4.6	Furnizimi me material dhe montimi i gypit shperndares te ujitjes me sistemin pike-pike. Ne cmim te kalkulohen edhe te gjitha pjeset fazonike per lidhjen e gypave dhe funksionalizimin e sistemit pike-pike.	m'	600.00	€	0.10	€	60.00	
TOTAL PUNET E SISTEMIT TE UJITJES							€	231.20
vërejtje	Pas perfundimit te puneve ne objekt te behet pastrimi dhe largimi i mbeturinave deri ne deponi.							
A	ARKITEKTURA							
I	PUNET PARAPERGADITORE					€	100.00	
II	PUNET E THEMELEVE					€	1,408.00	
III	PUNET E KONSTRUKSIONIT					€	3,298.00	
IV	PUNET E SISTEMIT TE UJITJES					€	231.20	
TOTALI							€	5,037.20

Emri i Kompanisë	N.SH. " Kastrioti "
Adresa e Plote	Fshati Prelez i Jerlive, Ferizaj
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	Muharrem Rushit
Pozita	Pronar
Nënshkrimi	
Data	03.11.2020
Vula	